

20151474161

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM PENSIONAL DHE**  
**INVALIDOR**

Neni 1

Në Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15 dhe 129/15) neni 221 ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 3 000 euro në kundërvlerë me denarë do t’u shqiptohet për kundërvajtje subjekteve nëse nuk parashtrojnë fletëparaqitje për sigurim në pajtim me nenin 125 paragrafi (4) pikat 1) dhe 4) nga ky ligj.

(2) Gjobë në shumë prej 300 deri në 400 euro në kundërvlerë me denarë do t’u shqiptohet për kundërvajtje subjekteve nëse nuk parashtrojnë fletëparaqitje për sigurim në pajtim me nenin 125 paragrafi (4) pikat 2), 3), 5) dhe 6) nga ky ligj.

(3) Gjobë në shumë prej 3 000 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet personit juridik të obliguar për përllogaritje dhe pagim të kontributit, nëse:

1. nuk paraqet të dhëna për fillimin dhe ndërprerjen e punës, dhe ndryshimet gjatë punës apo ato të dhënat i paraqet pas kalimit të afatit të përcaktuar nga neni 209 pika 1) nga ky ligj;

2. nuk paraqet të dhëna për sigurim, çlajmërimin e sigurimit dhe ndryshimet gjatë sigurimit apo i paraqet pas kalimit të afatit të përcaktuar nga neni 209 pika 2) nga ky ligj;

3. nuk paraqet të dhëna për stazhin e sigurimit, rrogat, kompensimt e rrogës përkatësisht bazat e sigurimit apo i paraqet pas kalimit të afatit të përcaktuar nga neni 209 pika 3) nga ky ligj;

4. paraqet të dhëna të pasakta për mbajtjen e evidencës amë nga neni 202 nga ky ligj dhe

5. në afatin nga neni 206 paragrafi (1) nga ky ligj që e ka përcaktuar Fondi, nuk e kryen korrigjimin e të dhënave për stazhin e sigurimit, rrogat, kompensimet e rrogës përkatësisht bazat e sigurimit.

(4) Gjobë në shumë prej 300 deri 400 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik të obliguar për përllogaritjen dhe pagimin e kontributit, nëse nuk vepron në pajtim me nenin 209 pikat 1), 2) dhe 3) nga ky ligj.

(5) Gjobë në shumë prej 3 000 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtje punëdhënësit nëse nuk vepron në pajtim me nenin 207-a paragrafi (3) nga ky ligj.

(6) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik nga paragrafi (3) i këtij neni do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës te obliguesi për përllogaritje dhe pagim të kontributit nëse nuk vepron në pajtim me nenet 202, 206 paragrafi (1) dhe 209 pikat 1), 2) dhe 3) nga ky ligj.

(7) Gjobë në shumë prej 300 deri në 400 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet personit i cili nuk do të paraqitet në sigurimin pensional nëse i plotëson kushtet nga neni 11 paragrafi (1) pika 14) nga ky ligj.

(8) Gjobë në shumë prej 300 deri në 400 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet personit zyrtar të Fondit nëse nuk vepron në pajtim me nenet 125 paragrafi (6), 132-a dhe 207-a paragrafët (1) dhe (5) nga ky ligj.

Neni 2

Neni 222 shlyhet.

Neni 3

Neni 223 ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 300 deri në 400 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet personit zyrtar në Fond nëse nuk vepron në pajtim me nenin 214 paragrafi (3) nga ky ligj.

(2) Për kundërvajtjet e parapara me këtë ligj procedurë kundërvajtëse mban dhe sanksion kundërvajtës shqipton gjykata kompetente.”.

Neni 4

Pas nenit 223 shtohet neni i ri 223-a, si vijon:

“Neni 223-a

Matja e lartësisë së gjobës për personat juridikë bëhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.”

Neni 5

Pas nenit 247-a shtohet neni i ri 247-b, si vijon:

“Neni 247-b

(1) Të siguruarit të cilët kanë status të bujqve individualë, për shkak të plotësimit të kushteve për realizimin e të drejtës së pensionit të pleqërisë, në stazh të sigurimit do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në sigurim sipas Ligjit për sigurim sipas pleqërisë të bujqve, nëse ka qenë i lajmëruar në sigurim dhe kontributi për atë sigurim është paguar në kohën kur ka qenë në fuqi Ligji për sigurim sipas pleqërisë së bujqve.

(2) Nëse i siguruari nga paragrafi (1) i këtij neni nuk ka stazh të përcaktuar të plotë të sigurimit pas 1 janarit 1989, për plotësimin e kushteve për realizimin e të drejtës së pensionit sipas pleqërisë, do të llogaritet koha e kaluar në sigurim sipas Ligjit për sigurim sipas pleqërisë të bujqve, nëse ka qenë i lajmëruar në sigurim dhe kontributi për atë sigurim është paguar kur ka qenë në fuqi Ligji për sigurim sipas pleqërisë të bujqve dhe nëse kryen pagesë të kontributit për sigurim pensional dhe invalidor për periudhën pas 1 janarit 1989, deri te plotësimi i kushtit prej 15 vjet stazh të sigurimit nëse ka qenë i lajmëruar në sigurim të detyrueshëm social pas 1 janarit 1989.”

Neni 6

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”, ndërsa dispozitat nga neni 5 nga ky ligj do të fillojnë të zbatohen prej 1 janari 2016.